

Kukësi

GUIDË TURISTIKE



Fig.1 Autorësia Besart Halilaj



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Përmbajtja

1. Gjeografia e Kukësit.....	3
2. Historia	4
3. Zhvillimi ekonomik dhe Turizmi	5
3.1 Turizmi Malor.....	6
3.2 Turizmi Natyror	7
3.3 Turizmi Kulturor	8
4. Destinacionet turistike Kukës	13
5. Referenca	17



GJEOGRAFIA

Qyteti i Kukësit shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Shqipërisë. Ai kufizohet në Veri-Lindje dhe Lindje me qytetin e Prizrenit (Kosovë) ku si pikë kontakti është dogana e Morinës dhe në brendësi të territorit Shqiptar kufizohet me Hasin në veri, Pukën në perëndim dhe Peshkopinë në Jug.

Kukësi ose Kukësi i Ri është vendosur në këmbë të malit të Gjallicës (2487 m) dhe është një ndër qytetet më të reja në Shqipëri. Përfundoi së u ndërtuari në vitin 1976 dhe vendin e Kukësit të Vjetër e zuri hapësira ujore prej 72,5 km² e liqenit artificial të Fierzës, i cili u ndërtua si rezultat i ndërtimit të Hidrocentralit me po të njëjtin emër.

Fig.2 Autorësia Ermal Onuzi

Baseni i këtij liqeni furnizohet nga dy lumenj të rëndësishëm, Drini i Zi (buron në liqenin e Ohrit) dhe Drini i Bardhë (buron në Malet e Rugovës, Kosovë), të dy këto degë formojnë Lumin Drin, më të gjatin në Shqipëri me 280 km i cili derdhet në Detin Adriatik nëpërmjet Gjirit të Lezhës. Bashkimi i dy Drinave i ka dhënë Kukësit formën e një gadishulli, gjë që i jep një pamje shumë piktoreske.

Ka një shtrirje veri-jug prej 1,4 km dhe lindje-perëndim prej 0,9 km. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 150 ha dhe lartësi mesatare 320-350 m mbi nivelin e detit.

HISTORIA

Mbi etimologjinë e toponimit Kukës¹

Mbi emrin e qytetit të Kukësit ka mendime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, por ka një shpjegim shkencor arkeologjik: në Kodrën e Pecës në fshatin Përbreg është gjetur mbishkrimi OYEKEIS që mund të lexohet UEIKEIS ose KUEIKEISI që të kujton emrin Kukës. Banorët e lashtë të kësaj treve sipas Beb Jubanit i quanin “Ilir Alpin”.

Sipas E.Paço, emri Kukës rrjedh nga fjala ilire Kuskulis.

Sipas Sh. Hoxhës, emri Kukës rrjedh nga emri i komandantit të garnizonit

Ahmet Kuka, i cili rreth viteve 1633 kontrollonte administratën ushtarake të këtij vendi. Mendohet se më afër të vërtetës për toponimin Kukës qëndron fjala latine Quercus (kurkus) që sot shqiptohet Kukës dhe që në shqip përkthehet me fjalën bungajë. Në të vërtete gropa e Kukësit ka qenë një bungajë. Ky rreth, krahas vlerave arkeologjike, ka vlera të çmueshme historike.

Më e spikatur është lufta e popullit të Lumës ndaj serbeve e zhvilluar në qafë të Kolosianit.

Fig.3 Autorësia Besart Halilaj



¹ www.kukesi.gov.al

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI

Relievi i rrethit të Kukësit dallohet për një larmishmëri në aspektin morfologjik, morfogjenetik dhe kontraste të mëdha hipsometrike, këto të fundit kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në modelimin e relievit, të klimës, dukurive ambientale që në tërsinë e tyre bëjnë më komplekse dhe interesante peisazhet.

Këto tipare luajtën një rol të rëndësishëm në formimin e dukurive të veçanta natyrore të cilat theksojmë:

- Shfaqjen e ekosistemeve të përbëra nga shoqërime interesante të botës bimore dhe shtazore që kanë vlera shkencore, ekologjike meritojnë të marrin statusin e zonës së mbrojtur.

- Zhvillimi i proceseve të erozionit dhe dinamika e proceseve ekzogjene kanë çuar në krijimin e formave dhe mikroformave të relievit me vlera dhe monumenteve të natyrës.

- Pasuritë dhe potencialet klimatike favorizojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, sporteve dimërore, në të njetën kohë ofrojnë dhe mundësi për zhvillimin e lëvizjeve turistike në dhe pranë objekteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Këto tipare gjeografike kanë ndikuar në formimin e një natyre tepër të ndërlikuar me zhvillim të vrullshëm,

që ka çuar në forminin e vlerave të veçanta, unikale, që kushtëzojnë një trashëgimi shumë të pasur natyrore.

Kjo pasuri natyrore e pranishme në rrethin e Kukësit merr vlera akoma më të mëdha nëse do ta integrojmë me trashëgiminë kulturore të trashëguar brez pas brezi dhe e vendosim në shërbim të turizmit.



Fig.4 Autorësia Ermal Onuzi



Fig.5 Autorësia Ermal Onuzi

TURIZMI MALOR

Turizmi malor në Kukës përfaqësohet nga këto aktivitete sportive :

Alpinizmi

Alpinizmi është një sport dimëror i bukur. Pllajat e bukura të Novosejt dhe Shishtavecit janë shumë të përshtatshme për zhvillimin e sportit të skive gjatë dimrit. Si pista argëtuese janë përdorur rrugët kryesore të fshatit. Në kuadër të këtij sporti në vitin 2000 dhe 2013 u organizua një kampionat ndërkombëtar i skive ku morën pjesë skiatorët vendas dhe skiatorë nga Norvegjia dhe Gjermania.

Sporti i Skive

Shishtavecit është një zonë që ka potencial të lartë në zhvillimin e turizmit. Aty dëborra, arrin edhe në 2 metra duke e bërë këtë vend të përshtatshëm për zhvillimin e këtij sporti. Me një natyrë të bukur në të gjitha stinët, në dimër Shishtavecit veshet petkun e bardhësisë, duke i dhënë një tjetër bukuri kësaj zone. Nëse e vizitoni këtë vend, mos u largoni pa provuar dhe gatimet tradicionale në bujtinat e ndryshme që Shishtavecit ka.

Hipizmi

Është një sport i zhvilluar hershëm traditë me shumë për zonën e Gorës, në zonën e Dollovishtit dhe në rrethinat e Prizrenit. Kuajt garues ka patur në Novosoj, Shishtavec, Borja. Kuajt për hipizëm janë ruajtur në regjim stallor e me një përkudësje të veçantë duke ushqyer me orare të caktuara. Hipizmi është zhvilluar më shumë në raste dasmash dhe festash tradicionale.



Fig.6 Autorësia Besart Halilaj



Fig.7 Autorësia Gëzim Cengu




Fig.8 Autorësia Bekim Fazliu

TURIZMI NATYROR

Në rrethin e Kukësit natyra ofron një sërë monumentesh të cilat të impresionojnë jo vetëm më madhështinë e tyre dhe vlerat shkencore, por dhe me pasurinë e bjeshkëve të pasura me vlera kurative. Të gjitha këto ofrojnë mundësi të mira për të kënaqur vizitorët dhe të apasionuarit ndaj natyrës dhe vlerave kulturore të zonave etnografike ku ato bëjnë pjesë siç janë:

Vargu Korab-Koritnik (ku bën pjesë mali i Gjallicës)

Liqeni i Fierzës

Kanioni i Vanave

Kanioni Bicajve (Shkalla e Keqe)

Guri i Mëngjesit, Shishtavec

Guri i Shqipës, Borje

Mështekna e Shishtavecit

Dushku Novosej

Pisha e Gjegjanit

Kroi i Kuq

Kroi Tanzot

Kroi i Kishëzës

Shpella e Jëzinës

Shpella Lojme, etj.



Fig.10 Autorësia Besart Halilaj

TURIZMI KULTUROR

Pozicioni në udhëkryqet e rrugëve mesjetare dhe më të reja, ka bërë të mundur që ky rajon të popullohet që në periudhat e hershme duke na lënë trashëgimi një pasuri të madhe kulturore.

Të dhënat arkeologjike kanë vërtetuar se pellgu i Kukësit është banuar që në shek. I të erës sonë. Sipas këtyre të dhënave vërehen këto periudha historike të neolitit, bronzit, hekurit që dëshmojnë lashtësinë e këtij vendbanimi. Vendbanimet me të lashta janë të Kolshit, Kënetës, si dhe tumat ilire në Qinamak, Bardhoc. Vende të tjera të vizitueshme arkeologjike janë: Vargu Korab-Koritnik (ku bën pjesë mali i Gjalicës) Liqeni i Fierzës, Kanioni i Vanave, Kanioni Bicajve (Shkalla e Keqe), Guri i Mëngjesit, Shishtavec, Guri i Shqipës, Borje, Mështekna e Shishtavecit, Dushku Novosej, Pisha e Gjeganit, Kroi i Kuq, Kroi Tanzot, Kroi i Kishëzës, Shpella e Jezinës, Shpella Lojme, etj

Kjo ndërtesë merr vlera për karakterin shumëfunktional si në aspektin arsimorë dhe atë patriotik.

Trashëgimia arkitekturore zë një vend të veçantë duke na shpalosur dhe një herë trashëgiminë e pasur të këtij rrethi.

Monumentet arkitektonike mund të klasifikohen në dy kategori kryesore: ndërtesa ku u zhvilluan ngjarje të rëndësishme historike dhe përmendore që i dedikohen figurave të rëndësishme historike.

- Shtëpi të tipit Kullë (Kulla e Shaqir Palushit në fshatin Bushticë, kulla e Ismail Aga Lumës në fshatin Bicaj ishin banesa të rëndësishme për patriotët gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit).

- Kulla e Rezistencës që gjendet në qytetin e Kukësit (në të cilën kremtohet mikpritja e ngrohtë e qytetarëve të Kukësit ndaj vëllezërve Kosovar).

TRASHËGIMIA MATERIALE DHE SHPIRTËRORE

Bashkia Kukës, përveç natyres malore ofron potenciale kulturore, ku përfshihet e gjithë trashëgimia materiale dhe shpirtërore e cila vihet në shërbim të turizmit.

Kukësi mund të konsiderohet dhe si djep i kulturës popullore. Është dalluar edhe për zhvillimin e artizanatit. Deri në vitin 1925 dominonte artizanati shtëpiak që plotësonte nevojat familiare për veshje dhe një pjesë të veglave të punës.

Artizanati filloi të zhvillohej vetëm pas vitit 1925, kur Kukësi u bë qendër prefekturë.

Zejet e para ishin fotografia, rrobaqepësia, zdrucktaria dhe frutaria. Vetëm pas viteve 1950 artizanati është bërë degë kryesore në Kukës.

Pjesë e kësaj oferte është dhe pasuria etnografike si: veshjet kombetare, këngët, vallet, instrumentat muzikor, prodhimet e artizanatit etj të cilat zgjerojnë ndjeshëm ofertën turistike.



Fig.11 Autorësia IntoAlbania

Etnografia është një element i spikatur në rrethin e Kukësit. Rrallë mund të gjejmë në ndonjë vend me një sipërfaqe kaq të vogël një gërshe-tim të tri zonave etnografike me tradita, zakone, veshje tradicionale të veçanta: Krahina Etnografike e Malziut, Krahina Etnografike e Lumës, Krahina Etnografike e Gorës. Historia rreth origjinës së tyre, traditat e zakonet e tyre, mënyra e gatimit të gjitha këto e shtynë turistin të vizitojë këtë rreth dhe ta vlerësojë atë. Këto krahina njihen për elemente të spikatura për sa ju takon veçorive të veshjeve tradicionale.

Kështu, dallohet veshja me mbështjellse e Lumës (veshja e bardhë); veshja e Gorës me mbështjellse e cila ka disa variante që ndryshon sipas moshës së përdoruesit të saj; veshja e Malziut për nga paraqitja ka një ngjashmëri të dukshme me veshjen e gjanë të Tropojës por ka një punim më të thjeshtë për sa i përket dekorimit të saj. Karakteristike për burrat, është veshja me tirqe e cila është një veshje e përgjithshme që përdoret pothuajse në të gjitha krahinat, duke ndryshuar nga njëra

Fig.12 Autorësia Besart Halilaj



Këngët e vallet:

Këngët interpretohen me çifteli, lahutë dhe fyll. Kërcimet interpretohen kryesisht me lodra, curle, gajde dhe çifteli. Vallja e shqipes dhe vallja me shpata e burrave të Lumës janë unike.



Fig.13 Autorësia Besart Halilaj



Fig.14 Autorësia Besart Halilaj

Punimet e dorës

Kukësi dallohet për prodhimin e përpunimin e qilimave dhe sixhadeve, të cilat janë shtroje tradicionale të leshta të punuara me veg. Për mënyrë qilimin e Lumës me kompozim rrrathësh koncentrik që qendërohen rreth një shqiponje të bardhë dykrerësh dhe qilimin e kuq të Gorës, të cilat kanë vlera origjinale që mund të shërbejnë dhe si objekt për tregun turistik. Qilimi Kuksian ka formën e një katërkëndëshi kënddrejt, dy palësh dhe është përdorur për shtrimin e odës së burrave dhe mbulimin e kuajve si një mbulesë.

Përveç punimeve në vek (sexhade dhe qilima), njihet dhe për punimet e dorës (punime me shtiza, qëndisje dhe punët e grepit), punime në gur (shtëpit e tipit Kullë), gdhendjet në dru etj. Puna me dorë me anë të shtizave, para viteve 50 ka qenë baza për veshjen e përditshme.

Fig.15 Autorësia Punime Artizanale Ora





Fig.16 Autorësia Gëzim Cengu

Kuzhina tradicionale: Në këto krahina gastronomia paraqet një interes të veçantë për turistët, vizitorët, eskursionistët dhe kalimtarët e rastit që frekuentojnë këtë zonë dhe që herës tjetër do të jenë vizitor për ta njohur atë. Banoret e Kukësit krenohen me prodhimet unike që ju ofrojnë mysafireve, siç janë: peshku i liqenit të Fierzes, Luciper, rakia e shtëpisë që prodhohet nga rrushi ose kumbulla, mjalti i gështenjes, flija (një byrek i pjekur në zjarr që bëhet me anën e nje saçi prej bakri), gatimet me patate, çorba e Gorës, gubjaniku, boza e famshme, djathi i bardhë i deleve (Çajës), kosi i famshëm i Kroit të Kuq, mishi i tharë, i pjekur, petë misri, pite (byrek), etj.



Fig.17 Autorësia Besart Halilaj

Festat tradicionale: Në Bashkinë Kukës, kremtohen shumë festa lokale që lidhen me traditat dhe kulturën e vendasve: **Dita e Shen Gjergjit**, festohet në gjysmën e parë të Majit që kremton fundin e dimrit dhe ardhjen e stinës së pranverës.

Dunmet, festohet në Surroj më 20 Shtator dhe është festë që lidhet me kthimin e bagëtive në fermat familjare nga kullotat verore në pllajtat e maleve.

Të Qethmet, festohet në Njësinë Administrative Terthore, të Enjten e dytë të Shtatorit. Është festë që lidhet me qethjen e deleve.

Gjallica, festohet të Enjten e parë të muajit Gusht dhe është festë pagane që lidhet me mbrojtjen e malit të Gjallicës.

Runa, festohet në Njësinë Administrative Malzi më 1 Korrik dhe është festë pagane ku njerëzit lutën për fuqinë e malit.

Dita e Verës, festohet në të gjithë rajonin më 14 Mars.

DISA DESTINACIONE PËR TU VIZITUAR NË KUKËS:

Muzeu

I pozicionuar në qendër të qytetit, është një godinë modeste e ndërtuar vitet e fundit. Në të do të gjeni informacion gjithëpërfshirës për historinë, etnografinë dhe biodiversitetin. Muzeu është i ndarë në tre pavione: Biodiversiteti, Arkeologjia dhe Etnografia.

Pavioni i Biodiversitetit

Kushtet klimatike të zonës e bëjnë këtë vend me një ekosistem të pasur që është i dokumentuar mirë me katalogjet fotografike të këtij pavioni. I njohur ndryshe si Qyteti i Tulipanëve, ku shumëllojshmëria e tulipanëve është më e pasura në vend. Ndër të tjera, Kukësi ka më shumë se 750 lloje bimë medicinale, 80 prej të cilave prodhohen e mblidhen nga fermerët vendas.

Pavioni Arkeologjik

Në pavionin arkeologjik ju do të njiheni mbi ekzistencën e qytetërimit kuksian, e cila daton që para 6000 viteve, para lindjes së Krishtit. Në zonën e Kolshit janë gjetur gjurmë që e dëshmojnë këtë fakt. Shfaqja e tumave ilire (kodërvarreve), në periudhën e bronzit, dëshmon gjithashtu për ekzistencën e Kukësit në antikitet.



Fig.18 Autorësia Besart Halilaj



Fig.19 Autorësia Besart Halilaj



Fig.20 Autorësia Besart Halilaj

Kanioni i Shkallës së Keqe

Kanioni i Shkallës së Keqe njihet si një mrekulli e natyrës, dhe gjendet pranë fshatit Bicaj në Kukës – rreth 30 minuta me makinë. Ky kanion është një monument natyror tejet unik, me rreth 1000 metra thellësi dhe ngushtësi prej 3 metrash. Ai mund të shihet me sy të lirë nga qendra e qytetit të Kukësit dhe është një atraksion turistik mbresëlënës që nuk duhet lënë pa u parë gjatë vizitës suaj të ardhshme në Kukës.

Mali i Gjallicës, Kukës

Mali i Gjallicës, rreth 2.489 metra lartësi ka një pamje të jashtëzakonshme dhe stoike që mund të vrojtohet nga çdo pikë e qytetit të Kukësit. Ky është mali më i lartë në Kukës dhe është pjesë e Alpeve Dinarike. Ky mal prej guri gëlqeror është i veshur me bimësi dhe pyje të shumta, sidomos pishash dhe ahu. Gjallica është mjaft i famshëm në rrethet e alpinistëve dhe për të organizuar ngjitje apo ecje në të, duhet medoemos organizimi i mirëfilltë me profesionistë të fushës.

Shishtavec

Shishtavec është një fshat i cili ndodhet 33 km në juglindje të qytetit të Kukësit. Një nga veçantitë e këtij fshati është prania këtu e një popullsie të ardhur sllave nga ish-Perandoria e Bullgarisë, të cilët e kanë ruajtur gjuhën dhe traditat e veta dhe tashmë janë pjesë e minoritetit

Bullgar të Shqipërisë. Shishtavec, në fakt, konsiderohet një monument natyror pasi ka një numër pikash turistike, relievesh natyrore, bjeshkët e Shishtavecit të cilat ndodhën në një lartësi prej 2130 metrash mbi nivelin e detit, por një pikë vërtetë interesante të cilën në duam t'ju sugjerojmë, është Guri i Mëngjesit. Ky masiv shkëmbor-ranor i gjendur në jug të Shishtavecit është pjesë e monumenteve natyrore shqiptare. Ky gur, i cili kë qenë një pikë referimi që në lashtësi, e ka marrë këtë emër pasi rrezet e para të diellit krijojnë një kurorë drite rreth tij. Ai gjendet në një lartësi 1900 metra mbi nivelin e detit dhe prej kohësh është kthyer në një pikë që vizitohet nga turistët që vizitojnë Bjeshkët e Shishtavecit. Hipizmi është një praktikë e kahershme në këtë zonë, ndaj dhe vazhdon të ushtrohet dhe është mjaft e kërkuar nga vizitorët.



Fig.21 Autorësia Ermal Onuzi



Fig.22 Autorësia Klodian Braha

Liçeni i Fierzës, Kukës

Liçeni artificial i Fierzës është krijuar në shtratin e lumit Drin në vitin 1978, në funksion të hidrocentralit të Fierzës. Liçeni shërben edhe si nyje lidhëse mes banorëve të rrethëve Kukës, Tropojë, Has dhe Pukë. Pamja magjepsëse në të gjitha stinët e vitit nuk mund ta linte liçenin e Fierzës jashtë listës tonë. Mes klimës alpine, hipizmit por edhe bukurive natyrore si liçeni, mali, kanionet, pyjet e luginat e ndryshme, Kukësi sapo ka filluar të njihet nga turistët dhe potenciali për t'u kthyer në një nga pikat më të kërkuara në rajon është vërtetë i jashtëzakonshëm.

Shtegu i Ngjyrave, Kukës

Pjesë e turizmit rural është edhe kjo zonë e njohur me emrin 'Shtegu i Ngjyrave' pasi ky shteg ofron një pamje shumëngjyrëshe të luleve të ndryshme në këtë livadh alpin në Kukës. Ky vend gjendet pranë kufirit që lidh Shqipërinë me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, dhe fillon nga mali "Çaja" deri në luginën e Korabit. Edhe pse ka disa nyje lidhëse, kjo ecje alpine mund të zgjasë diku tek 7 orë gjatë të cilave grupi mund të vizitojë monumente natyrore si "Gryka e Vanave", Ujëvara e Belës apo edhe liçeni i Kallabakut. Mos e humbisni!

- Gryka e Çajës
- Kanioni i Bicajve
- Kanioni i Vanave
- Guri i mengjezit
- Liçeni i Kallabakut
- Topojani



Fig.23 Autorësia Ermal Onuzi

I financuar nga projekti ReLOaD 2 ky material synon promovimin e destinacioneve turistike të bashkisë Kukës me mundësi shfrytëzimi të ekoturizmit, kulturës, kulinarisë etj. Kjo guidë ka një rëndësi strategjike të zhvillimit ekonomik për zonat e bashkisë Kukës të cilat mund të kthehen në destinacione shumë të frekuentuara dhe që zgjerojnë hartën e zonave turistike të vendit.

REFERENCA

1. Gjeografia Fizike e Shqipërisë (Physical Geography of Albania), 1990, 1991 Vol. I.dhe II Tiranë
2. Dragoti N., Dedej Z., Abeshi P., 2007. Zonat e mbrojtura të Shqipërisë (Protected areas of Albania). Tiranë
3. Dida M., Dragoti N., Kromidha G., Fierza Gj., 2004. Zonat Natyrore të Shqipërisë. Parqet kombëtare. Tiranë
4. Dollma M. 2006. Geography 3. Cultural and Natural Heritage, a book for Medium School. Tirana
5. Noka H. 2004. Një Guidë për Kukësin.
6. Qiriazhi P., Hoxha G., Kola B., 2007. Gjeografia 3, libër për shkollat e Mesme. Tiranë
7. Qiriazhi P., Bego F., 1999. Monumentet e Natyrës të Shqipërisë. Tiranë
8. Serjani A., Heba G. 1996. Gjeotrashëgimia në Shqipëri, Studime gjeografike Nr.9. Tiranë
9. Serjani A., Neziraj A., Ë. A. P. Ë Imbledon, Onuzi K., Hallaçi H., Bushati S., 2003. Gjeomonumentet dhe Gjeoturizmi në Shqipëri (Geological Heritage and Geotourism in Albania). In both: Albanian and English versions. Tirana
10. Avdia B., Gjeomonumentet dhe Trashëgimia Kulturore si Mundësi për Zhvillimin e Gjeoturizmit në Rrethin E Kukësit, Mitrovicë 2011
11. Avdia B., Gjeomonumentet dhe Trashëgimia Kulturore si Mundësi për Zhvillimin e Gjeoturizmit dhe turizmit në Krahinën e Lumës dhe Gorës, Tiranë 2012.
12. www.kukesi.gov.al



#ReLOaD

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2)”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës Youth Act dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).